

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-146/15**

**Prishtinë**

22 Mars 2017

Në çështjen juridike të:

**M. U.**

**Pala ankuese**

N/A

**Pala përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur rreth ankesës kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014 të datës 18 qershor 2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA54216), pas shqyrtimit të mbajtur më 22 Mars 2017 mori këtë:

## AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga M. U. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014 të datës 18 qershor 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA54216, refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/247/2014 i datës 18 qershor 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA54216.

### Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 17 dhjetor 2007, M.U. (në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese) duke vepruar në emër të babait të tij të ndjerë Đ. U., ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP), duke kërkuar të drejtën e ri-posedimit mbi barakën me sipërfaqe prej 30.91 m<sup>2</sup> që gjendet në rrugën “Marshall Tito” nr.152, Komuna e Pejës (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar) si dhe kompensim për shkatërrimin e pronës. Ai deklaroi se prona e kërkuar ishte humbur për shkak të rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë në periudhën 1998/99, duke cekur 12 qershorin 1999 si datën e humbjes.
2. Për ta mbështetur kërkesën, pala ankuese i dorëzoi në AKP këto dokumente:
  - Kontratën e Qirasë nr. 3064 të lidhur më 11 qershor 1960 ndërmjet Ndërmarrjes “Fabrika e Drurit Pejë” në cilësinë e qiradhënësit dhe Đ. U. në cilësinë e qiramarrësit. Paragrafi dy (2) i Kontratës specifikon se Qiraja do të ketë efekt ligjor deri në ndërprerjen e punësimit të Đ. U.,
  - Faturën e datës 16 tetor 1965 që tregon se Đ.U. ia kishte paguar Ndërmarrjes “Fabrika e Drurit Pejë” 99.994 dinarë (Monedhë Jugosllave) për banesën sipas Vendimit nr. 01-4312/65,
  - Çertifikatën e Vdekjes nr. 2.4 të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit Civil të Pejës më 19 tetor 1992 që tregon se Đ. U. ka vdekur më 25 korrik 1992,
  - Fatura të ndryshme që tregojnë se familja U. i kishte bërë pagesat e tatimeve.
3. Më 14 qershor 2011, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së bëri identifikimin fizik të kërkesës. Sipas raportit, prona e kërkuar u gjet si objekt tërësisht e shkatërruar dhe shkurre.

4. Kërkesa është konsideruar e pakontestuar pasi që asnjë palë nuk ka shprehur interesim për të marrë pjesë në procedurën brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079.
5. Sekretaria Ekzekutive e AKP-së nuk i ka gjetur asnjëherë nga provat e dorëzuara nga pala ankuese, pavarësisht përpjekjeve të saj.
6. Më 18 qershor 2014, Komisioni përmes vendimit të saj KPCC/D/R/247/2014 e hodhi kërkesën poshtë me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur ta tregojë të drejtën e pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998-1999.
7. Më 23 tetor 2014, vendimi i KKKP-së iu dorëzua palës ankuese ndërsa ai paraqiti ankesë para Gjykatës Supreme më 17 nëntor 2014.

### **Pretendimet e palës ankuese**

8. Pala ankuese e kundërshton Vendimin duke pretenduar se ai bazohet në vërtetim të mangët dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
9. Pala ankuese deklaroi se familja e tij e ka pasur të drejtën e pronësisë dhe posedimit mbi pronën e kërkuar duke shpjeguar se babai i tij fillimisht e kishte marrë me qira pronën e kërkuar në bazë të Kontratës së Qirasë nr. 3064 dhe në vitin 1985 e kishte ri-blerë pronën e kërkuar përmes Vendimit nr.01-4312/65 dhe e kishte paguar tërë shumën e çmimit. Prova tjera që sipas palës ankuese dëshmojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar janë faturat për pagesën e tarifës për shfrytëzimin e tokës ndërtimore.
10. Në bazë të lartcekurave, pala ankuese kërkon që Gjykata Supreme ta anulojë Vendimin e KKKP-së dhe ta vërtetojë të drejtën e pronësisë dhe ri-posedimit në dobi të tij.
11. Ankesës i janë bashkëngjitur të njëjtat dokumente të cilat janë shqyrtuar nga shkalla e parë.

### **Arsyetimi ligjor**

### **Pranueshmëria e ankesës**

12. Ankesa është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Ligjit nr.03/L-079 dhe është e pranueshme.

## Meritat e ankesës

13. Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrtoi ankesën në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore nr.03/L-006 (më tej: LPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese konstatoi se ankesa është e pabazuar.
14. Në përputhje me nenin 3.1 të Ligjit nr.03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në urdhër nga KKPK-ja për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës “dëshmon” të drejtën e tij të pronësisë apo të drejtën për shfrytëzimin e pronës private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe po ashtu dëshmon se ai/ajo nuk është në gjendje t’i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërliohen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
15. Sipas kësaj dispozite ligjore, pala ankuese është dashur të dorëzojë prova për ta dëshmuar të drejtën e pronësisë ose të drejtën për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme.
16. KKPK-ja e bazon Vendimin e saj në faktin se pala ankuese nuk kishte arritur të ofrojë ndonjë provë, që do të mund të verifikohet nga AKP-ja, se babai i tij si bartës i së drejtës pronësore gëzon ndonjë të drejtë pronësie mbi pronën, si dhe për shkak se Sekretaria Ekzekutive nuk i ka siguruar ato prova *ex officio*. Kjo është ngase Sekretaria Ekzekutive e AKP-së kishte bërë verifikim negativ të dokumenteve mbi të cilat pala ankuese e bazon pretendimin e tij për pronësi.
17. Pala ankuese deklaroi se babai i tij e kishte blerë pronën e kërkuar në përputhje me Vendimin nr.01-4312/65; megjithatë, ai nuk e dorëzoi Vendimin në fjalë. Pretendimi si i tillë është shqyrtuar nga shkalla e parë dhe pavarësisht përpjekjeve të saj, Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur ta verifikojë Vendimin nr.01-4312/65 *ex officio*.
18. Ankesa e palës ankuese thirret në pretendimet tërësisht të njëjta sikurse ato të deklaruara para KKPK-së. Asnjë provë e re nuk është paraqitur në ankesë.
19. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë Vendim të drejtë, të bazuar në procedurë korrekte dhe të plotë.
20. Sa i përket kërkesës për kompensim, as Komisioni e as Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme nuk kanë mandat dhe japin vendim mbi kërkesat për kompensim sa i përket pronës së shkatërruar. Vet ligji nr. 03/L-079 nuk parasheh mekanizëm kompensimi për pronën e shkatërruar.
21. Në bazë të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

## Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr.03/L-079, ky Aktgjykim im është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it**

**Beshir Islami, Gjyqtar**

**Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it**